



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, duke vendosur sipas kërkesës Nr.1-400-69762 të datës 08.11.2021 të Shoqatës së HANDIKOS dega në Lipjan, Kryetari i Komunes nxjerr:

VENDIM PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 200 € (dyqind euro), Shoqatës së HANDIKOS dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400-69762 të datës 08.11.2021, për realizimin e një aktiviteti tre ditorë në rastin e "3 dhjetorit – ditës ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuar" për vitin 2021.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2021 pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhirollogarinë bankare të Shoqatës së HANDIKOS dega në Lipjan, në nr. 1907960372031135 në BKT bankë.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara i lartëcekuri duhet të sjell raport dëshmi deri në shumën e lejuar dhe të njëjtat ti dorëzojë në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport..

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Shoqatës së HANDIKOS dega në Lipjan.

1Nr.400-69762

Lipjan, më 23.11.2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

